


**UDHA
ORTODOKSE**



Peshkop Kallistos Ware

**Kallistos Ware
Peshkop i Dioklisë**

Udha ortodokse

E përktheu At Foti Cici

Titulli i originalit:
The Orthodox Way,
Bishop Kallistos of Diokleia
Revised edition
St Vladimir's Press, New York 1998

© Rev. Fr. Foti Cici

All rights reserved. No part of this Albanian translation may be reproduced or transmitted, in any form or by any means, without the prior permission of the translator.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij libri të përkthyer në shqipe mund të riprodhohet a të përcillet, me çfarëdo trajte a mënyre, pa kërkuar më parë lejen e përkthyesit.

Toronto, 2005

Shënim i përkthyesit

UDHA ORTODOKSE është një paraqitje përmbledhëse e doktrinës, adhurimit dhe jetës së të krishterëve ortodoksë, nga teologu më i njohur ortodoks në Perëndim, Kallistos Ware (Oxford). *Udha ortodokse* ngre çështjet themelore të teologjisë: Zoti si i fshehur, dhe megjithatë i zbuluar; problemi i së keqes; natyra e shpëtimit; domethënia e besimit; lutja; vdekja dhe çfarë fshihet tej saj.

Me këto shtjellime ky libër i përkthyer në shumë gjuhë, ndihmon për të mbuluar nevojën e një katekizme bashkëkohore, pa qenë një manual i ngurtë të dhënash. Çështjet doktrinale shihen këtu jo si teori abstrakte për debate teologjike, por si tema me pasoja në gjithë jetën e njeriut.

Paraqitjen e peshkopit anglez e vijon një begati tekstesh marrë nga teologë e shkrimtarë spiritualë të të gjitha kohërave, ortodoksë e jo. Këto citime e zbulojnë ortodoksinë jo si një sistem besimi, praktikash a zakonesh, por tej e ndanë si *Udhë*.

* * *

Ky përkthim është botimi i dytë, i ripunuar, i *Udhës ortodokse*. Versioni i parë u paraqit vitin e kaluar në këtë bibliotekë virtuale, ku vazhdon të ekspozohet për ata që mund t'a parapëlqejnë. Edhe pse i pabotuar në versionin fizik *Udha ortodokse* është lexuar nga qindra shqipfolës.

Të interesuarit do të vërejnë tashmë se *Udha*, në krahasim me versionin e vjetshëm në Internet, sjell ndryshime të tjera në tekstualitet. Një nga arsytet e ndryshimeve është ai që nuk përjashton asnjë përkthim; të gjitha përkthimet janë subjekt ndreqjeje e lëvizjeje, përderisa vetë gjuha rrjedh e ndryshon, duke tërhequr në vrundujt e saj edhe folësit e shqipes. Ndjeshmëria dhe përgjegjësia e përdoruesve të gjuhës standarde janë realitete që tejkalojnë këtu emocionet që na shkakton periudha jonë gjuhësore, me gjithë paragogët e saj politikë e kulturorë në zonën ortodokse.

Zot a Perëndi?

Ky do të jetë një nga ndryshimet që lexuesit do të vërejnë mu në titujt e kapitujve. Fjala *Perëndi* është e zëvendësuar në shumicën e rasteve, me *Zot*. Në fakt, në një manual katekizme ortodokse unë do të përdoja gjithandej termin me nuanca liturgjike tashmë, *Perëndi*, dhe do të përdorja *Zot* vetëm atje ku është

teologjikisht “korrekt”. Por ja që i drejtohem me këtë përkthim shqiptarit të gjuhësuar me fuqinë e natyrshme të standardit, ku rëndom përdoret *Zoti*, dhe jo *Perëndia*. Gjithsesi, në citimet biblike e liturgjike, unë kam lënë në përkthim trajtat tradicionale.

Citimet biblike megjithëse janë paraqitur në thonjëza nuk përbëjnë vargje të përkthyer nga një botim i posaçëm në shqipe. Përkthimi i *Dhjatës së Re* nga Konstandin Kristoforidhi në toskërishte, i cili përdoret si tekst zyrtar në kishën ortodokse në Shqipëri, nuk i përmbahet gjithmonë origjinalit, përderisa rëndom ai imiton përkthimet që ka pasur si ndihmë. Pra, atje ku Kristoforidhi nuk e jep të qartë vargun biblik, është marrë parasysh origjinali në greqishte, duke u këshilluar dhe me përkthimet e tjera në shqipe si dhe ato në anglishte e në greqishten e re.

Pasazhet e himneve të kishës ortodokse janë përshtatur në gjuhën e lexuesit por është ruajtur poetika e gjuhës së adhurimit. Përveç teksteve anglisht janë përdorur dhe tekstet origjinale bizantine, ndërsa nga përkthimet e Nolit janë marrë parasysh ato të periudhës së parë, 1908 - 1914. Përkthyesit i rinj, në qoftë se nuk e njohin greqishten bizantine, duhet të kenë parasysh se përkthimet noline të periudhës së parë janë më të përshtatshme kur kërkojmë të shprehim më me plotësi gjuhën e origjinalit, ndërsa përkthimet e periudhës së dytë, 1941-1952, për hir të përshtatjes muzikore e kanë sakrifikuar plotërinë e origjinalit. Ndërsa ato himne që nuk janë përkthyer ende në shqip, janë përkthyer këtu sipas traditës ekzistuese, por duke ruajtur kriteret e këtij përkthimi.

Në pamundësi për t'i ndihmuar bashkëkohësit e mi me një botim fizik të këtij libri të rëndësishëm në literaturën ortodokse të përbotshme, shpresoj se kjo paraqitje e re do të jetë më e përdorshme për ata që duan të futen në brendinë e botës ortodokse, ose thjesht që duan të kuptojnë ortodoksët. Unë, si prift misionar ndër shqiptarë ortodoksë, mjaftohem me urimet tuaja në heshtje, kudo që jeni, por dhe për vërejtjet e sugjerimet, nëse keni mirësinë të më dërgoni: AtFoti@ShqiptarOrtodoks.com.

At Foti Cici, më 22 janar 2005

Pak fjalë mbi autorin

Peshkop Kallistos (Kálistos) Ware lindi në Angli, në vitin 1934. Studimet i kreu në Universitetin e Oksfordit, ku dhe punoi si profesor i studimeve lindore ortodokse deri në përmbarrim të karrierës akademike.

Në Pashkët e vitit 1958 u bë anëtar i Kishës Ortodokse. Më 1965 u shugurua dhjakon, më 1966 prift dhe në vitin 1982 peshkop, duke marrë titullin e njëjës prej peshkopatave të moçme ilire: Peshkop i Dioklisë. Është britaniku i parë që u zgjodh peshkop i Kishës Ortodokse qysh nga ndarja e kishave perëndimore e lindore (epoka e Skizmës, Shekulli XI).

Imzot Ware është autor i librave *The Orthodox Church* (botuar e ribotuar me emrin e tij paramurgjërës Timothy Ware), i cili ka qarkulluar në mbi 150.000 kopje, *Eustratios Argenti*, një studim për jetën dhe veprimtarinë e teologut të shekullit XVIII, dhe *The Orthodox Way*, të cilin po paraqesim tashmë në shqipe. Imzot Ware është autor i shumë punimeve shkencore mbi studimet ortodokse, botuar kohë pas kohe në revista të ndryshme teologjike e akademike, të cilat po botohen në katër vëllime nga shtëpia botuese e Shën Vladimirit në New York.

Hirësia e Tij Kallistos është marrë me përkthime të veprave klasike të ortodoksisë në anglishte. Është bashkautor i përkthimit nga greqishtja të veprës madhore të spiritualitetit ortodoks, *Filokalia*, në pesë vëllime, si dhe të veprave liturgjike *Mujori Kremtues* dhe *Triodi*. Ka qenë dhe është editor i disa periodikëve teologjikë dhe veprimtar në lëvizjen ekumenike të kishës ortodokse.

Librat e tij janë përkthyer në shumë gjuhë të huaja, ndërsa Imzot Kallistos ka privilegjin të jetë sot teologu më i njohur i kishës ortodokse në Perëndim. Mbas tërheqjes nga detyrat e plota akademike në Oksford, ai jep mësim tashmë në institutin e studimeve ortodokse që ka bashkthemeluar në Universitetin e Kembrixhit, si dhe vazhdimisht udhëton për të kumtuar në universitete të ndryshme të botës, e për të predikuar në kisha ortodokse të juridiksioneve të ndryshme.

Parathënie

Tregues në udhë

Unë jam udha, edhe e vërteta, edhe jeta.

Joani 14 : 6

Kisha nuk na jep një sistem, por një kyç; nuk na jep një skicë të Qytetit të Zotit, por mënyrën për t'u futur në të. Ndoshta dikush do t'a humbasë rrugën sepse nuk e ka këtë skicë. Por atë që do të shohë, do t'a shohë pa ndërmjetës, do t'a shikojë drejtpërdrejt, do të jetë e vërtetë për të; ndërsa ai që ka studiuar vetëm skicën rrezikohet të ngelet jashtë dhe të mos gjejë me të vërtetë asgjë.

At Georges Florovsky

Një nga etërit më të famshëm në Egjiptin e shekullit të katërt, shën Serapion Sindoniti, shtegtoi një herë për t'u falur në Romë. Atje i thanë për një grua të dëgjuar, e cila ishte ngujuar dhe jetonte gjithmonë në një dhomë të vogël, pa dalur kurrë jashtë. Duke mos besuar për mënyrën e saj të jetesës (sepse vetë ai ishte një endacak i madh) Serapioni e vizitoi dhe e pyeti: "Përse po rri këtu?" Dhe ajo iu përgjigj: "Nuk po rri, udhëtoj".

Nuk rri; udhëtoj. Çdo i krishterë mund t'i thotë këto fjalë për veten e tij. Që të jesh i krishterë do të thotë të jesh udhëtar. Gjendja jonë, thonë etërit grekë,¹ është si ajo e popullit izraelit brenda shkretëtirës së Sinait: jetojmë në çadra, jo në shtëpi, sepse shpirtërisht jemi gjithmonë në lëvizje. Udhëtojmë nëpërmjet hapësirës së brendshme të zemrës, në një udhëtim që nuk matet me orët e sahatit, as me ditët e kalendarit, sepse është një udhëtim jashtë kohës dhe brenda përjetësisë.

Një nga emrat më të lashtë për krishtërimin ishte thjesht "Udha". "Në atë kohë, thuhet në Veprat e Apostujve, u bë një zhurmë jo e vogël në lidhje me Udhën" (19:23); Filiku, qeveritari romak i Qesarisë, përmendet të ketë thënë "se i dinte më hollësisht punët e Udhës" (24:22). Është një vlerësim që vë në dukje karakterin praktik të besimit të krishterë. Krishtërimi është diçka më tepër sesa një teori për gjithësinë, diçka më tepër sesa mësim të shkruara në letër; është

¹ "Etërit grekë" quhen autorët kishtarë që shkruan në greqishte, edhe pse në shumicën e tyre ata nuk ishin grekë në veçorinë racore (Nënshënimet janë të përkthyesit).

një shteg që marrim duke udhëtuar - me kuptimin më të thellë dhe më thelbësor, *udha e jetës*.

Ka vetëm një mënyrë për të zbuluar natyrën e vërtetë të krishtërimit. Duhet t'a nisim hapin në këtë shteg, të mësohemi me këtë mënyrë jetese dhe pastaj do të fillojmë të *kuptojmë vetë*. Për sa nuk ia kemi arritur kësaj, nuk mundemi të kuptojmë siç duhet. Pa dyshim është e nevojshme të na jepen udhëzime para se të nisemi; duhet të na thonë se çfarë do të kërkojmë, dhe për këtë na nevojiten edhe bashkudhëtarë. Me të vërtetë pa u drejtuar nga të tjerë është pothuaj e pamundur të fillojmë udhëtimin. Por udhëzimet që dhanë të tjerët kurrë nuk mund të na bëjnë të ditur se si është në të vërtetë udha; nuk mund të zëvendësojnë përvojën e drejtpërdrejtë dhe personale. Secili ftohet të verifikojë për veten e tij gjithë çka mësuar, secilit i nevojitet të rijetojë traditën që ka trashëguar. "Besorja, - thotë mitropolit Filareti i Moskës, - nuk të përket nëse nuk e ke jetuar". Askush nuk mund të udhëtojë i rehatshëm në këtë rrugë që është më e rëndësishmja nga të gjitha. Kurrkush nuk mund të jetë i krishterë i dorës së dytë. Zoti ka fëmijë, por nuk ka nipër e mbesa.

Si i krishter i Kishës Ortodokse dua të nënvizoj veçanërisht faktin e *përvojës së gjallë*. Në fund të shekullit të njëzetë tek shumë njerëz kisha ortodokse duket kryesisht interesante për frymën e lashtësisë dhe të konservatorizmit të saj; mesazhi i ortodoksëve ndaj vëllezërve perëndimorë ngjet me fjalët "jemi e kaluara juaj". Por për vetë ortodoksët besnikëria ndaj traditës nuk nënkupton medoemos pranimin e formave apo të zakoneve nga brezat e kaluar, por më saktë përvojën e shenjtë, gjithmonë të re, personale dhe të drejtpërdrejtë, *në të tashmen*, këtu dhe tani.

Duke përshkruar një vizitë në një kishëz fshati në Greqi, John Betjeman thekson elementin e lashtësisë, por thekson gjithashtu edhe diçka më tepër:

Brenda thellësisë së kubesë dita humbet.
Këtu, ku lutesh kur ndez një qiri,
Flaka e qiririt ndriçon sytë-bajame
të shenjtoreve vendorë, të cilët të vështrojnë pa habi.
Në mure gdhendur martirizimi i tyre,
ku pikon duke u filtruar drita e mëngjesit.
Flaka zbulon këtu figurat e plasaritura –
kaltërsia e detit, e gjelbër, e artë dhe e kuqe
dhe përmes tek dallohen grimcat e drurit –
me të puthura të pafund mbi ikonat,
ndoshta qysh nga shekulli XIV...

Kështu, fuqimisht lartësohet pema e lashtë
e krasitur nga përndjekjet dhe e vaditur me gjak
duke fundosur rrënjët e saj të gjalla gjer
në baltën e parakrishterë.
Nuk i lipset asnjë përkujdesje burokratike.
Është ngjallja e saj e vazhdueshme...

Këtu Betjeman tërheq vëmendjen tek shumë gjëra nga ato që një ortodoks i konsideron si të shumëçmuara: vlerën e gjesteve simbolike, siç është ndezja e një qiriri; roli i ikonave që shprehin një kuptim të kishës lokale si "qielli mbi dhë"; rëndësinë e martirizimit përmes përvojës ortodokse - nën turqit që nga viti 1453 dhe nën komunizmin që nga viti 1917. Ortodoksia në botën moderne është me të vërtetë një "pemë e vjetër". Por veç moshës ka gjithashtu gjallëri, një "ngjallje e vazhdueshme"; dhe kjo është ajo që ka rëndësi dhe jo vetëm lashtësia. Krishti nuk tha "unë jam zakoni"; Ai tha, "unë jam Jeta".

Qëllimi i këtij libri është të zbulojë shkaqet e thella të kësaj "ngjalljeje të vazhdueshme". Libri tregon disa nga piketat për të arritur në majat e kësaj udhe shpirtërore. Këtu nuk bëhen përpjekje për të dhënë një raport të ngurtë të historisë së shkuar dhe gjendjes bashkëkohore të botës ortodokse. Të dhëna për këto kushdo mund të gjejë në veprën time të mëparshme *The Orthodox Church* (Penguin Books), që u botua për herë të parë më 1963, dhe qarkulloi si botim i rishikuar më 1993 dhe 1997; dhe, sa është e mundur, jam përpjekur të shmang çfarë përmendet atje.

Synimi im në këtë libër është të jap një raport përmbledhës të mësimëve themelore të kishës ortodokse, duke iu afruar besimit si mënyrë jetese dhe mënyrë lutjeje. Ashtu si Tolstoi titulloi një nga tregimet e tij të shkurtra "Si jetojnë njerëzit", kështu mund të quhej edhe ky libër, "Si jetojnë të krishterët".

Në një epokë të hershme dhe më formale mund të merrte trajtën e një "katekizme për të rritur", me pyetje dhe përgjigje. Por unë nuk kam patur për qëllim këtë. Shumë pak flitet këtu për kishën dhe karakterin e saj "sinodik", për shoqërinë e shenjtoreve, misteret, kuptimin e adhurimit liturgjik; ndoshta këto mund t'i bëj temë të një libri tjetër. Teksa u referohem sekteve të tjera të krishtera, nuk bëj asnjë përqasje sistematike. Dëshira ime është të përshkruaj në sensin pozitiv besimin me të cilin jetoj si ortodoks, sesa të jap sugjerime në zona marrëveshjeje a mosmarrëveshjeje me katolicizmin apo protestanizmin.

Duke dashur të dëgjohet zëri i dëshimive të tjera dhe më të besueshme, përveç simes, kam përfshirë shumë citime; veçanërisht në fillim dhe në fund të çdo

kapitulli. Citatet më të shumta janë marrë nga librat liturgjikë ortodoksë që përdoren në adhurimin tonë përditë, apo nga ata që i quajmë *etër*, të cilët janë autorë kryesisht të tetë shekujve të parë të historisë së krishtërimit, por në disa raste, edhe të mëvonshëm; sepse një shkrimtar në ditët tona ka të ngjarë të jetë gjithashtu "At". Këto fragmente janë "fjalët" që kanë ndihmuar më shumë tek unë personalisht, si udhërrëfyes për kërkimet e mia personale në Udhë. Pa dyshim ka shumë autorë të tjerë, që nuk janë përmendur me emër, të cilëve gjithashtu u jam referuar.

O Shpëtimtar, që udhëtove bashkë me Llukën dhe Kleopën
tek Emausët; udhëto me shërbëtorët e tu tani që po marrin
Udhën dhe ruaji nga çdo e keqe (*Lutje në fillim të udhëtimit*).

E kremte e shën Joan Teologut, 26 shtator 1978